ARCHIVAL POST

# vendim-internim-debimi-nr-9-date-30-5-1986

SECTION


Inernment Decisions

PERIOD

1986 - 1986

# Media 1

MEDIA ITEMS #1



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
KOMISIONI I INTERNIMIT E DËBIMIT

S e k r e t
Ekzemplar Nr. 1
Tiranë, më 30 . 5 .1986

VENDIM Nr.9

Komisioni i Internimit e Dëbimit i mbledhur më datën 30 . 5 .1986, në bazë të dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr.5912, datë 26.6.1979, pasi mori në shqyrtim propozimet e paraqitura nga Ministria e Punëve të Brendshme,

V e n d o s i :

1. A [redacted] i datëlindjes 1963, lindur e banues në qytetin e Tiranës, shtresë e varfër, me arsim 8 vjeçar, beqar, punëtor, i padënuar, me kombësi e shtetësi shqiptare.

Vëllai i tij, A [redacted], në vitin 1984 është arrestuar në Jugosllavi dhe kohët e fundit ka të dhëna se vepron kundër vendit tonë. Nëna e tij, Sh [redacted] së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes janë internuar për pesë vjet kohë me vendimin nr.8, datë 25.4.1986 të Komisionit, nga qyteti i Tiranës në fshatin Dushk të rrethit të Elbasanit, ndërsa A [redacted] gabimisht nuk është propozuar.


Të internohet për pesë vjet kohë në fshatin Dushk të rrethit të Elbasanit.

Afati i internimit i fillon më datën 30 . 5 .1986 dhe i mbaron më datën 30 . 5 .1991.

T'i revokohet masa e internimit :

1. M [redacted], e datëlindjes 1962, internuar për pesë vjet kohë me vendimin nr.8, datë 25.4.1986 të Komisionit, nga qyteti i Tiranës në fshatin Dushk të rrethit të Elba-

MEDIA ITEMS #2



2.

sanit, për arsye se ka qenë e martuar me A [redacted] në vitin 1982, por është ndarë me vendim gjyqi në vitin 1983 dhe ndryshimet në gjendjen civile nuk ishin bërë.

Nga verifikimi i bërë del se M [redacted] është martuar me Adrian Deliallisin në vitin 1982 dhe kanë bashkëjetuar vetëm 2 muaj (nëntor-dhjetor 1982) dhe me vendimin nr.5, datë 27.4.1983 të gjykatës popullore të rrethit të Tiranës janë çkurorëzuar, por veprimet në gjendjen civile nuk janë bërë pasi gjykata nuk ka njoftuar për këtë sipas nenit 31 të ligjit 5840, datë 20.2.1979.

Megjithëse M [redacted] është e ndarë me A [redacted] e nuk ka bashkëjetuar me të, t'i revokohet masa e internimit.

ZËVENDËSKRYETARI I KOMISIONIT
HEKUZAN ISAI


KRYETARI I KOMISIONIT
MANUSH MYFTIU

A N Ë T A R Ë

KRAPI MINO

ARANIT ÇELA

MEDIA ITEMS #3



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDSHME
DREJTORIA I DEGA VIII
nr.3761

S e k r e t
Eksemplar nr.
Tiranë, më 7.5.1986

L ë n d a : Për [redacted]


DREJTORISË PUNËVE TË BRËNDSHME
AMËS SIGURIMIT
T I R A N Ë

Në [redacted], ashtu e të përmendurës më lënë i ka dërguar ajo letër Komisionit të Internimit e Dëbimit dhe ankohet se vajza e saj, [redacted] për një kohë prej 3 vjetësh ka qënë e ndarë nga A[redacted] e vendim të gjykatës të rrethit të Tiranës, nr.505 të vitit 1983 dhe nuk kanë patur asnjë lloj marrëdhënie me të.

Paverësisht se ajo nuk ka bërë ndryshimet në gjendjen civile, të verifikohen pretendimet që ngre [redacted] dhe në përfundim na kthehi përgjigje për të njëjtuar Komisionin.

ZËVENDËSKRYETARI DEGËS VIII
NAZMI DOMI

MEDIA ITEMS #4



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PUNËVE TË BRENDSHME
Ana e Sigurimit
Nr.1807/1

"S E K R E T"
Eksemplar Nr.
3761/1
19.5.86
Tiranë më 12.5.1986

L Ë N D A : Mbi M[redacted] P[redacted] Ç[redacted]

MINISTRISË PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORISË PARË
DEGËS VIII-të.
T I R A N Ë

Përgjigje tuajës Nr.3761 date 7.5.1986

M[redacted] ([redacted]) është e bija e M[redacted] dhe e H[redacted], lindur në Tiranë në vitin 1952 dhe banuese në fshatin Dushk të rrethit Elbasan,me arsim të mesëm,e divorcuar pa fëmijë,e padëshmar,e paorganizuar,me kombësi e shtetësi shqiptare.


M[redacted] deri më dt.10.5.1986 ka qënë e martuar me A[redacted], vellai i të cilit A[redacted],është arratisur jashtë shtetit dhe aktualisht ndodhet në SHBA.Ky i arratisur nëpërmjet korespondences së tij,ka lidhjet për arratisje. Fjestaret e familjes së tij,jo vetëm që nuk e denojnë aktin e tradhëtisë së tij,por në menyrë të maskuar mbajnë korespondencë me të,nga ana tjetër,ata vazhdimisht kanë kërkuar ndihmë ekonomike nga ky i arratisur.

Mbi këto baze,propozuan internimin familjar të lidhjeve të të katijë të arratisuri,konkretisht të familjes së Sh[redacted] (nëna e [redacted]) që është edhe kryefamiljare.Ndaj saj me dt.3.5.1986,u bë internimi për 5 vjetë kohë i familjes së tyre në fshatin Dushk të rrethit Elbasan.Nëna e internimit u mundë edhe ndaj M[redacted] që është pjestare e familjes së Sh[redacted]-mit (nusja e djalit të saj).

M[redacted] që kur është martuar e deri në kohën që ju komunikua nëna e internimit,ka bashkëjetuar me A[redacted],kjo veç të tjerave vërtetohet edhe nga këto fakte:

-Në muajin Prill 1986,M[redacted] sebashku me bashkëshortin e saj A[redacted] kanë shkuar tek koshilltari i bllokut nr.[redacted] dhe kanë kërkuar prej tij që të bëjnë shkëputjen nga trungu familjar (nga Sh[redacted]) dhe i kanë thënë se

MEDIA ITEMS #5



- 2 -

do te bashkjetojme si trung familjar me vete.

-MS dt.3.5.1986,kur familjes se Sh[redacted], ju komunikua vendimi i internimit,bashkeshorti i M[redacted], [redacted] ka:une do te shkoj te marr edhe gruan time,qe tani eshte tek vjerra.

-Ne certifikaten e gjendjes familjare te Sh[redacted],renditej si bjestare e familjes se saj edhe M[redacted] (nusja e djalit).

MS dt 10.5.1986 motra e M[redacted]ka shkuar ne zyren e gjendjes civile, ku ka paraqitur nje vendim te Gjykates se Rrethit Tirane me Nr.505 dt.27.4.1983,me anën e te cilit tregohej,se M[redacted] ishte shkrorezuar nga bashkeshorti i saj,A[redacted] M[redacted]me anen e te cilit (vendimit) ka bërë edhe ndryshimet përkatese (ndarjen).

Pretendimi qe ngrihet,se M[redacted]([redacted]) prej vitit 1983 nuk bashkjeton me A[redacted],nuk qendrojne sepse:

Nga njera ane ajo,pa e detyruar njeri ka bashkjetuar me të;dhe nuk ka dashur te shkurorezohej nga ai,pasi askush nuk e ka penguar dhe s'mund ta pengonte te bente ndarjen ne gjendjen civile,ne nje kohe qe ajo k'shte edhe vendimin e gjykates.


Nga ana tjeter,ajo jo vetem qe ka bashkjetuar me A[redacted],por sëbashku me te më dt.26.4.1986 ka shkuar ne zyren e gjendjes civile dhe kane bërë shkeputjen nga trungu familjar (nga S[redacted]) duke krijuar keshtu nje trung te ri familjar me kryefamiljar A[redacted]

Pra,sig del edhe nga sasipër,M[redacted]si faktikisht edhe juridikisht ka bashkjetuar me A[redacted],prandaj kemi qene dhe jemi te mendimit qe M[redacted](te mos i hiqet masa e internimit).

Bashkelidhur me kete shkrese po ju kthejme edhe letren e qytetares [redacted] [redacted]

DREJTORI I DREJTORISE P.BRENDSHME

MEDIA ITEMS #6



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA I DEGA VIII

Sekret.
Ekzemplar Nr.1..
Tiranë më 31.5.1986

Nr. 3766/1

L ë n d a : Për shfuqizim e masës vendimi.

DREJTORISË SË PUNËVE TË BRENDSHME
ANËS SË SIGURIMIT
TIRANË

DEGËS SË PUNËVE TË BRENDSHME
ANËS SË SIGURIMIT
ELBASAN

Komisioni i Internimit e Dëbimit me vendimin Nr.9, datë 30.5.1986 vendosi të internojë për pesë vjet kohë personin që vijon :

1.- A[redacted], i datëlindjes 1963.

Të internohet për pesë vjet kohë më fshtin Dushk të rrethit të Elbasanit.

Afati i internimit i fillon më datën 30.5.1986 dhe i mbaron më datën 30.5.1991.

Të përmbahurit t'i komunikohet masa e Komisionit kundrejt firmës, më pranë të një përfaqësuesi të pushtetit, t'i tregohen detyrat dhe të drejtat që ka më vëndin e internimit.


T'i revokohet masa e internimit personit që vijon :

1.- M[redacted]( Delialliaj ), e datëlindjes 1962.

Më përfundim të mbatimit të këtij vendimi të informohet Dega e VIII e Drejtorisë së I-rë.

ZËVENDËSKRYETARI I DEGËS SË VIII
AGIM ZEKA

MEDIA ITEMS #7



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME
DREJTORIA E PUNEVE TE BRENDSHME
Nr. 2239 Prot.

SEKRET
Eksemplar Nr.
Tirane me 21.5.1986

L E N D A: Propozohet internimi individ i A D

MINISTRISE SE PUNEVE TE BRENDSHME
DREJTORISE SE PARE
DEGES SE TEXTE.
T I R A N E:

Drejtoria e Puneve te Brendshme Tirane, propozon internimin individ per 5(pese) vjet kohe te A


A eshte i biri i S dhe i S , lindur ne Tirane ne vitin 1963 nga nje familje punetore, i pa organizuar, i pa denuar, i martuar pa femije, me arsim 8-vjecar, me pune ne Kombinatin e Autotraktoreve "Enver Hoxha", me banim ne Lagjen Nr , Rruga " , Nr , me kombesi e shtetesi shqiptare.

I permenduri rrjedh nga nje familje punetore. I jati i tij gjate regjimit antipopullor te Zogut dhe okupac'onit te vendit nuk eshte marre me politike, mbas clirimit te vendit ka punuar si punetor dhe aktualisht ka vdekur. Nena e tij, S eshte me origjine nga fshati Hoshtim i Vlores, rrjedh nga nje familje fshatare e varfer qe ka mbajtur qendrim te mire gjate luftes Nacionalclirimtare, ka ardhur ne Tirane pasi u martua dhe eshte vendosur me pune ne NFA-1, njihet me qendrim te keq moral dhe aktualisht eshte e internuar ne fshtain Dushk te Elbasanit.

Gruaja e tij: eshte me origjine nga Vlora, rrjedh nga nje familje me qendrim te mire, ka punuar si arketare ne dhe aktualisht ndodhet e internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit.

A ka nje vella dhe dy motra. S i cili eshte beqar dhe ndodhet i internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit, e cila eshte beqare dhe

MEDIA ITEMS #8



ndodhet e internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit, ndersa A eshte e martuar ne Tirane. A ka gjithsejtu edhe tre vellezer e dy motra me babe tjeter; A i cili ne vitin 1984 eshte arratisur ne Jugosllavi, R eshte i martuar dhe i internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit dhe P i cili eshte i martuar dhe banon ne Lagjen Nr. Tirane. Motrat e tij: B eshte e martuar ne Kaliq te Korces dhe Z eshte e martuar ne Tirane.

Vete A ne vitin 1978 ka mbaruar shkollen 8-vjecare dhe ka qendruar nje kohe te gjate pa pune, me vone eshte futur si nxenes ne ekonomi per mesimin e profesionit te tornitorit. Ne vitin 1981 eshte thirrur per te kryer sherbimin e detyrueshem ushtarak te cilin e ka mbaruar ne vitin 1983. Po kete vit eshte futur ne pune ne Kombinatin e Autotraktoreve "Enver Hoxha" ku ndodhet aktualisht. Njihet si njeri grindavec e nuk mban qendrim te mire.

I permenduri eshte i pergjegjshem para ligjes dhe nuk eshte i zgjedhur ne organet e pushtetit.

Vellai i tij, A me Korrik te vitit 1984 eshte arratisur ne Jugosllavi dhe ka shkuar ne SHBA. Nga te dhenat qe disponojme, A ka levizur ne shume shtete te botes dhe aktualisht ndodhet ne Jugosllavi ku pergatitet te vije si diversant ne vendin tone. Ne gjithe pjestaret e familjes se A , jo vetem nuk e denojne tradhetine e vellait te tij por edhe mbajne korrespondence ne menyre te maskuar me te e korkojne ndihma ekonomike nga A ndersa ky i fundit i nxit per tu arratisur jashte shtetit.

Nisur sa e'per propozojme qe A te internohet ne fshatin Dushk te rrethit te Elbasanit ku eshte e internuar edhe familja e tij per nje kohe prej 5(pese)vjetesh.


PUNONJESI OPERATIV
ARTAN HALLKU

SHEF I SEKSIONIT TE KATERT
PERPARIM ZHUPA

DREJTORI I DREJTORISE SE PUNEVE TE BRENDSHME
AGRON

Komisioni i internimeve te rrethit te Tiranes ne mbledhjen e tij date 1986 shqyrtoi propozimin per internim te t

MEDIA ITEMS #9




dhe ra dakort me propozimin e bere nga ana e Drejtor'se se Punev te Brendshme Ti-
rane.

KRYETARI I KOMITETIT EKZEKUTIV TE KP RRETHIT

LLAZI GEGPRIFTI

MEDIA ITEMS #10



S E K R E T

Eksemplar Nr._____

Tirane me ___.5.1986

VERTETIM BIOGRAFIK I PLOTE PER

A____ S___ B_____.


JANE VERTETUAR: A- [redacted] eshte i
biri i Sp[redacted] dhe i [redacted]lindur ne Ti-
rane ne vitin 1963 nga nje familje pune-
tore,i pa organizuar,i pa denuar,i martu-
ar,pa femije,me pune ne Kombinatin e Au-
totraktoreve "Enver Hoxha",me banim ne
Lagjen [redacted]
me kombesi e shtetesi shqiptare.

I permenduri ne vitin 1978 ka mbaruar shkollen 8-vjecare dhe ka
qendruar per nje kohe te gjate pa pune,me vone eshte futur si nxenes ne ekonomi per
te mesuar profesion'in e tornitorit ku qendroi deri ne vitin 1981;kohe ne te cilen
u thirr per te kryer sherbimin e detyrueshem ushtarak te cilin e mbaroi ne vitin
1983.Pasi e kreu ushtrine u fut ne pune ne Kombinatin e Autotraktoreve "Enver Ho-
xha",ku ndodhet edhe aktualisht.Njihet si njeri grindavec dhe nuk mban qendrim te
mire.

Babai i tij:S[redacted] eshte me origjine nga Tirana,rrjedh
nga nje familje e varfer,gjate regjimit antipopullor te Zogut dhe gjate okupacionit
nuk jane marre me politike,mbas clirimit te vendit ka punuar si punetor ne nderma-
rje te ndryshme,aktualisht ka vdekur.

Nena e tij:[redacted] eshte me origjine nga fsha-
ti Hoshtime i rrethit te Vlores,rrjedh nga nje familje fshatare e varfer,ka ardhur
ne Tirane mbasi eshte martuar dhe eshte futur ne pune ne [redacted],aktualisht eshte ne
pension dhe ndodhet e internuar ne fshatin Dushk te rrethit te Elbasanit.[redacted] ne
pare ka qene e martuar me A[redacted] dhe gjate kohes qe ky ishte ne burg(pa-

MEDIA ITEMS #11



si ishte i denuar me 12 vjet heqje liri'je per vjedhje te pasurise socialiste) u lidh me [redacted] me te cilin beri 5 femije jashte martesen.Njihet si femer imorale dhe e shthurur,e qe merret me aborde.

Gruaje e tij:[redacted] eshte me origjine nga Vlora, rrjedh nga nje familje me qendrim te mire,ka pas punuar arketare ne [redacted],aktualisht ndodhet e internuar ne fshtain Dushk te Elbasanit.

A[redacted] ka nje vella dhe dy motra,[redacted] cili ishte beqar, aktualisht ndodhet i internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit,[redacted] e cila ishte beqare dhe aktualisht ndodhet e internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit dhe A[redacted] e cila eshte e martuar ne Tirane.A[redacted] ka gjithashtu edhe tre vellezer dhe dy motra me babe tjeter.Vellezerit e tij:A[redacted] ne vitin 1984 eshte arratisur ne Jugosllavi,[redacted] i cili eshte i martuar ne Tirane,ka pas punuar ne Fabriken e Porcelanit,aktualisht ndodhet i internuar ne fshatin Dushk te Elbasanit dhe [redacted] i cili eshte i martuar dhe banon ne Tirane ne [redacted],Motrat e tij:L[redacted] eshte e martuar ne Malig te Korces dhe [redacted] e cila eshte e martuar ne Tirane. Keta femije,nena e A[redacted] [redacted] it ka me burrin e pare qe qubej M[redacted]


Karakterizohet familja e tij se gjate regjimit antipopullor te Zogut dhe okupacionit te vendit ka mbajtur qendrim indiferent,mbas clirimit te vend-it,nuk ka mbajtur qendrim te mire per vete faktin se nje vella i tij Agimi eshte i arratisur ne Jugosllavi,ndersa e jema ka mbajtur qendrim te ulet moral.

PUNETORI OPERATIV
ARTAN HALOKU

SHEFI I SEKTORIT TE KATERT
PERPARIM ZHUPA

DREJTORI I DREJTORISE SE PUNEVE TE BRENDSHME
AGRON TARE

MEDIA ITEMS #12



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRËNDSHME
DREJTORIA I DEGA VIII
Nr. 3764

Sekret
Ekzemplar nr...
Tiranë, më 7.6.1986

L ë n d a : Për M[redacted] dhe A[redacted].

DREJTORISË PUNËVE TË BRËNDSHME
AMËS SIGURIMIT
T I R A N Ë


Me vendimin nr.9, datë 30.5.1986 të Komisionit të Internimit e Dëbimit iu revokua masa e internimit M[redacted] dhe u internua A[redacted], ish bashkëshorti i saj, i cili nuk ishte propozuar nga ana juaj njëherësh me familjen për internim.

Në informacionin e paraqitur për këtë qëllim, kryetari i Komisionit, shoku Manush Myftiu, ka vënë këtë shënim : " Duhet sqaruar pse Komisioni i Tiranës nuk e ka patur të qartë këtë çështje që kur e shqyrtoi. Po kështu edhe Drejtoria e Punëve të Brëndshme Tiranë".

Mbi sa sipër, në përfundim të informohet Dega VIII e Drejtorisë I, me qëllim që të njoftohen shokët e Komisionit.

ZËVENDËSKRYETARI DEGËS VIII
NAZMI DEMI

MEDIA ITEMS #13



REPUBLIKA POPULLORE SOCIALISTE E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME
DREJTORIA E PUNEVE TE BRENDSHME
Nr. 1049/9

S E K R E T
Ekzemplar nr.....
Tiranë, më 26.5.1986


L Ë N D A : Mbi zbatimin e një vendimi.

MINISTRISE PUNEVE TE BRENDSHME
DREJTORISE PARE
DEGES VIII
T I R A N Ë

Përgjigje tuajes nr.3761/2 datë,31.5.1986.
Ju njoftojme se vendimi nr.9 datë 30.5.1986,i Komisionit të Internim
Debimit u zbatua si me poshtë:
1.A [redacted] u internua për 5 vjet Kohë në Dushk të rr-
ethit të Elbasanit.
Mbersa për A [redacted] u njoftua Komiteti Ekz.
i kp;të rrethit mbi revokimin e masës internimit.

ZEVENDESDREJTORI I PUNEVE TE BRENDSHME
PELIVAN LUÇI

MEDIA ITEMS #14



REPUBLIKA POPULLORE SOC.SHQIPERISE
MINISTRIA E P.BRENDSHME
DEGA E P.BRENDSHME
Nr.991

S e k r e t
Ekzemplar Nr. 1
Elbasan,me 18.6.1986


L e n d ë : Mbi zbatimin e një vendimi.

MINISTRIS PUNVE TE BRENDSHME
DREJTORIS I-re
DEGES VIII-te
T I R A N E

Ne lidhje me tuajen Nr.8761,date 31.5.86,
ju njoftojme se u zbatua vendimi Nr.9,date 30.5.1986 i komisionit te
Internim-Debimeve per internimin e A [redacted] nga
qyteti i Tiranes ver ne sekterin Dushk te VB Belesbit Elbasan.
Gjithashtu ju komunikua ~~heqjen e~~ revokimi i masës se
internimit vere kohe A [redacted]

ZEVENDESKRYETARI I DEGES P.BRENDSHME
PANDELI LLUKMANI

MEDIA ITEMS #15




INFORMATION

No additional information is available for this media.

TRANSCRIPT

No transcript is available for this media.